

Sfida e medias lokale në Shqipëri gjatë pandemisë Covid

Julian Hoxhaj

Pandemia e koronavirusit do të lërë pas pasojat më të mëdha në ekonominë e vendeve të prekura prej saj. Në Shqipëri mbyllja për shkak të pandemisë ka krijuar efektet e para në ekonomi. Mijëra vende pune u mbyllën, shumë biznese rrezikojnë falimentimin, ndërsa sektorë të caktuar të ekonomisë rrezikojnë të përballen me efekte afatgjata të krizës. Në këtë spirale të rrezikshme është futur dhe media. Televizionet dhe gazetat apo radiot, u përballën me pasojat që krijoi mbyllja e ekonomisë për shkak të pandemisë. Televizionet lokale kanë qenë nga më të prekurit nga kjo krizë.

Rrudhja e tregut të reklamave

Sfida e parë me të cilën u përballën mediat lokale ishte pikërisht rrudhja e tregut të reklamave. Në intervistat që pronarët e mediave lokale kanë dhënë pak javë më parë për Portavendore.al, kanë treguar pikërisht se sfida e parë e tyre ishte heqja e reklamave nga bizneset të cilat u mbyllën për shkak të pandemisë. *“Po që se kjo do vazhdojë dhe s`do ketë më as reklama, i bie që ta mbyll fare. Jemi në ditët më të vështira që ka qenë televizioni ndonjëherë. Reklamat janë larguar.”*, u shpreh Ardian Asllani, pronari i Best Channel në Elbasan, një nga televizionet më të mëdha lokale të këtij qarku.

E njëjta situatë është dhe në Vlorë dhe Fier. Televizioni 6+1 Vloja, një nga televizionet lokale më të mëdha në jug të vendit, ndihet i prekur nga reduktimi i ndjeshëm i reklamave, që thuhet se kanë arritur nivelin zero. Edhe bizneset që kanë reklamuar vazhdimisht në këto televizione, tashmë kanë kërkuar ndërprerjen e transmetimit. *“Reklamat na kanë ikur të gjitha, sepse këtu ka. Ne kemi për shembull reklama traqetesh, por edhe traqetet s`punojnë. Kemi reklama restorantesh dhe restorantet nuk punojnë, kemi mobilieri dhe mobilieritë nuk punojnë, kemi lokale, kemi dhe taksitë, por ato nuk punojnë, kështu që të gjitha llojet e bizneseve që sjellin reklama, nuk punojnë.”*, shprehet Albert Deliaj pronari i 6+1 Vloja.

Në një situatë të vështirë gjendet edhe TV Apollon, Fier. Edhe pse një nga televizionet më të vjetër dhe shtrirje në disa qarqe, duket se situata nga koronavirusi ka krijuar vështirësitë e para reale për këtë media lokale. *“Të flasim bazuar në realitetin që prekim çdo ditë. Tre biznese që reklamojnë prej vitesh u tërhoqën dhe nuk kanë fuqi financiare për të paguar”*, tregon Artur Rustemi pronari i Tv Apollon në Fier.

E njëjta situatë është dhe në radio. Ndonëse më kosto më të ulëta se televizionet, radiot përsëri kanë hasur vështirësi në këtë situatë. Pronari i Radio Klea në Elbasan, Taulant Pilavi tregon gjithashtu se reklamat janë larguar, paçka se ai tregon se për muajin mars ka shlyer detyrimet ndaj punonjësve të radios së tij. *“Në këtë moment, ne na ka mbaruar lënda e parë, dmth neve na ka mbaruar oksigjeni, që kur filloi kjo situata, që në datën 10 mars. Sepse filluan reklamat më datë 1, në datë 10 u mbyllën. Iku marsi me 20 ditë të tëra, erdhi prilli dhe po e njëjta situatë. Nuk*

ka asnjë reklamë deri më tani. Ka dy muaj pushim, ndërkohë dhe ne po vazhdojmë me forcat tona sa të kemi mundësi”, tha ai.

Largimi i gazetarëve nga puna

Mungesa e financave solli si pasojë edhe largimin e gazetarëve apo punonjësve të tjerë nga puna në këto media. Gjatë intervistës për të njëjtin artikull, pronari i 6+1 Vlora Albert Deliaj u shpreh se punoi me staf të reduktuar për shkak të pandemisë. *“Unë deri tani kam rezistuar nuk kam hequr njeri, i kam dhënë nga 70-80 % të pagës njerëzve që kanë punuar një ditë po një ditë jo, p.sh kanë punuar 15 ditë dhe kanë marrë 70-80 % të rrogave. Nuk është se i kam lënë pa bukë në kuptimin e mirë të fjalës. U kam dhënë nga 25-30 mijë lekë të reja, sepse kështu po punojmë 15 ditë njëri, 15 ditë tjetri.”*, thotë Deliaj.

Me staf të reduktuar ka punuar dhe Best Channel në Elbasan, tregon pronari i këtij televizioni Ardian Asllani. *“Nuk kam bërë shumë shkurtime të them të drejtën megjithatë do shohim këtë muaj. Muajin mars e mbyllëm, mirë keq e mbyllëm, disa kanë punuar 15 ditë. Ca ishin, ca nuk ishin, të shohim tani në muajin prill”*. Por ai paralajmëron se nëse situata vijon në këtë gjendje, do të ketë pamundësi në pagesat e punonjësve.

Edhe në TV Apollon, Fier, po punohet me staf të reduktuar, madje shpesh një punonjës mund të kryejë disa funksione njëkohësisht. Ndërkohë, deri më tani 7 punonjës të këtij televizioni nuk janë në punë për shkak të pamundësisë financiare të drejtuesit për t'i paguar. *“Media lokale ka pësuar traumë që 1-2 vjet para..., por unë i kam mbajtur se kam pasur të ardhura të tjera, kam pasur objekte me qira, dhe i kam shfrytëzuar qiratë për kryerjen e pagesave të punonjësve. Funksionojmë me dy punonjës, një montazhier, kam zgjedhur punonjësit më të specializuar dhe një punonjës bën tre specialitete brenda, bën montazh, bën pultin, dhe kameraman”,* thotë z. Rustemi.

Aleksandër Çipa, Kryetar i Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, konfirmon se deri më tani janë shkurtuar deri në 30% e punonjësve. *“Ne këtë javë po mbledhim raportimin në të gjitha degët e Unionit dhe ka një situatë të tillë. Një pjesë e medias lokale ka shkurtuar 20-30% të stafit dhe ata që janë, e kanë në diskutim pagën sepse atyre edhe ia vonojnë nga 1-2 muaj rrogën. Plus që pagat janë tepër të ulëta, 150-200 mijë lekë të vjetra. Por normalisht dhe ato e kanë reduktuar 30% të stafit. Flasim gjithmonë për redaksitë e gazetarëve se pjesën tjetër po e po që e shkurtojnë”*.

Gazetarët pa sigurime dhe kontrata

Një nga problemet e gazetarëve në mediat lokale është mungesa e sigurimeve shoqërore apo e kontratave të punës. Këtë gjë e tregon Vali Qyrfyçi kryetare e Unionit të Gazetarëve në Durrës.

“Të drejtat e punës për gazetarët janë çështje të lirisë së medias dhe demokracisë. Në mënyrë që të mos cenohet pavarësia dhe paanshmëria e tyre, gazetarët duhet të kenë kontrata të rregullta pune, të cilat të ofrojnë mbështetje, mbrojtje shoqërore, po dhe kur kontratat ekzistojnë, ato janë më së shumti fiktive dhe nuk e ofrojnë mbrojtjen e dëshiruar. Për sa i përket kontratave të punës dhe pagimit të sigurimeve shoqërore-shëndetësore, situata, ashtu si në të gjithë vendin edhe në Durrës paraqitet e paqëndrueshme. Ka gazetarë të siguruar, ashtu siç ka dhe të pasiguruar. Profesionit i gazetarit është shumë stresues, kërkon volum dhe cilësi të lartë pune, ndërsa paguhet pak. Edhe kur kontratat ekzistojnë, ato shpesh janë formale dhe nuk reflektojnë kushtet reale të punës, pagën reale, nuk respektohen pushimet vjetore të përcaktuara në to etj”, tha Vali Qyryçi, duke vijuar se e gjithë kjo problematikë, nuk ka ende një zë të fuqishëm nga gazetarët dhe për gazetarët. E njëjta gjë ndodh, sipas Figurit, edhe në Lezhë.

Gjendja nuk paraqitet më e shëndetshme as në televizionet lokale të qytetit të Shkodrës, ku siç shprehet një gazetarë që punon në këto media *“70% e gazetarëve të Shkodrës janë të siguruar ndonëse nuk kanë firmosur një kontratë pune. Pjesa më e madhe ka vite që punon në media, ndërsa ata të cilët janë të pasiguruar janë kryesisht persona që shihen si të përkohshëm në atë media, si p.sh studentë apo persona të dypunësuar në shtet ose privat”*. Në Kukës gjithashtu situata paraqitet shqetësuese nga vetë gazetarët, të cilët punojnë krejtësisht në të zezë, pa kontrata pune dhe pa sigurime.

Financat ndikojnë te raportimi korrekt

Mungesa e financave në mediat lokale ka ndikim direkt dhe në misionin e medias. Shpesh, për shkak të varësisë financiare nga bizneset vendore apo dhe pushteti lokal, mediat lokale anashkalojnë raportimin e problematikave në komunitetet ku ato transmetojnë sinjalin e tyre. Këtë gjë e kanë pranuar vetë drejtuesit dhe pronarët e këtyre televizioneve. Një pronar i një televizioni lokal në qytet bregdetar të jugut të vendit, Sarandë, që dëshiron të mbetet anonim, tregoi se problematikën e qytetit shpesh nuk raportohen. Sipas tij, kjo bëhet me qëllim që të mos dëmtohet biznesi i turizmit në qytet.

Edmond Isaku, kryetar i Shoqatës së Mediave Lokale në Shqipëri, tregon gjithashtu të njëjtën situatë. Por, ai thotë se në shumë raste edhe kur mediat raportojnë problematikën në qytetet e tyre, pushteti lokal nuk reagon. Sipas tij, arsyeja lidhet me faktin se mediat lokale nuk kanë shikueshmëri në Tiranë, aty ku është pushteti qendror dhe ku mund të ketë reagim.

Ndërhyrjet e politikës dhe biznesit gjithashtu janë fenomene, që mund të censurojnë publikimin e lajmeve në mediat lokale. Në Shkodër, drejtuesja e televizionit lokal, “Rozafa”, pohon këtë fakt, ndërsa tregon gjithashtu se tendenca për të qenë i pavarur dhe apolitik, ka bërë që të ardhurat e televizionit të jenë në vështirësi. *“Duke dashur se ne duam të mbajmë një standard të krijuar, nuk ka censurë nga pronari ose dikush tjetër, por mund të ketë ndërhyrje nga politika apo nga ndonjë parti ose ndonjë njohje e vogël me individë, sepse vetë pronarët kanë dashur të mbajnë*

këtë standard, duke qenë se është gjithçka me vetëfinancim”, shprehet ajo, ndërsa një gazetar i një media tjetër lokale në Shkodër ka gjykimin e tij lidhur me këtë situatë.

“Në Shkodër pronarët e medias janë biznesmenë të afirmuar në fushën e ndërtimeve , turizmit dhe transporteve, teksa përdorin pronësinë e medias për të reklamuar biznesin e tyre dhe pse jo për të ndikuar indirekt apo direkt median në fuqizimin e këtij biznesi. Një tjetër burim të ardhurash janë reklamat nga biznesi, apo njoftimet e vdekjeve dhe përvjetorëve, të cilat dy media në qytet i kanë burim konstant dhe të pandërprerë të ardhurash prej thujse 20 vjetësh. Kujtojmë se fushatat elektorale janë një burim i padeklaruar të ardhurash, pasi subjektet politike apo kandidatët paguajnë për hapësirën e tyre televizive apo për spote elektorale”, tha një gazetar lokale e Shkodrës. Ndërsa i pyetur për fondet në Tv Kukësi, një gazetar lokal i tha Portës Vendore se: “Media këtu jeton me lëmoshë dhe me fondet që mbledh kur pushteti vendor ka ndonjë fushatë promovimi, ndërsa gazetarët kanë frikë nga të fortët”.

Sigurimi i informacionit në mediat lokale

Për shkak të faktorëve të përmendur më sipër, gazetarët në mediat lokale përballen me forma të ndryshme të censurës apo autocensurës. Për shkak të ligjit për të drejtën e informimit, ligj që në shumë aspekte i ka ndihmuar gazetarët, autoritetet vendore e përdorin në favorin e tyre. Kështu, marrja e informacionit të shpejtë për ngjarje të caktuara bëhet i pamundur në bashki apo institucione të tjera, të cilat tashmë kërkojnë shkresa zyrtare për të dhënë informacion. *“Në Shkodër pushteti vendor ka zyra shtypi ku gazetarët i drejtohen për marrjen e informacionit apo kërkesës për intervista në sektorë të ndryshëm. Në bashkinë Shkodër, gazetarët e kanë gjetur formën për të siguruar informacionin përmes burimeve dhe ndërhyrjet vijnë më shumë nga linja editoriale dhe vetëcensurimi që sjell kjo, sesa nga hermetizmi i informacionit në tërësi”,* tha për Portën Vendore një gazetar lokale e qytetit të Shkodrës.

“Gazetarët lokalë nuk e kanë të vështirë të sigurojnë informacionin e duhur, por informacioni zyrtar është shumë i ngadaltë duke iu referuar shpejtësisë me të cilën operon media vizive dhe ajo online. Ka gjithmonë ndërhyrje që synon censurimin e lajmeve, por së fundmi ka një tendencë nga pushteti vendor për të rritur presionin ndaj gazetarëve, në mënyrë që ata të vetëcensurohen”, tha Gjergj Figuri, Kryetar i Unionit të Gazetarëve për qarkun e Lezhës.

Censura dhe autocensura sipas ekspertëve

Pronarët e televizioneve konfirmuan se faktori ekonomik është vendimtar në lirinë e medias. Këtë mendim e ndajnë dhe ekspertët. Ramadan Çipuri, profesor dhe studiues i mediave, pak kohë më parë ka bërë një studim për format e censurës dhe lirisë së medias në Shqipëri, duke përfshirë mediat lokale. Për Portën Vendore ai tregoi gjithashtu se faktori ekonomik është i rëndësishëm për të pasur liri, por shton edhe interesat e tjera të pronarëve. Ai shprehet se:

“Shqetësimi im për mediat lokale nis që me qëllimin e hapjes së tyre nga pronarët që i administrojnë. Nga kontaktet që kam pasur me drejtues dhe pronarë të mediave lokale jashtë Tiranës, kam vënë re se në një pjesë e konsiderueshme e tyre janë ose zgjatime të bizneseve të caktuara, ose media që nuk kanë një synim të qartë për të vijuar me misionin që u takon. Në këto kushte, liria e mediave lokale është shumë më e kufizuar se ajo e mediave kombëtare. Arsyeja e parë është se mediat lokale sot janë të pafuqishme për të mbijetuar financiarisht. Atyre iu mungojnë reklamat, produksionet, stafi i specializuar, e shumë elementë të tjerë që mund të krijojnë alternativa për burime financiare. Në këto kushte, ato detyrohen të bashkëpunojnë me aktorë të jashtëm, qofshin këto biznese, grupe të ndryshme interesi, apo edhe politikë. Së dyti, në vende të vogla, sidomos në qytetet shqiptare, ekziston një problem i madh që ka të bëjë me njohjet e njerëzve me njëri-tjetrin, rrjedhimisht edhe me lidhjen e interesave të tyre, por edhe të aktorëve të ndryshëm shoqërorë. Duke qenë kështu, media lokale e ka të vështirë të investigojë në çështje që prekin interesat e ngushta të individëve, por që cenojnë interesin publik.

Ai eidenton dhe një tjetër element, të konfirmuar nga gazetarët e intervistuar nga Porta Vendore. Shpesh është më e lehtë të pasqyrosh një problematikë të një qyteti në mediat kombëtare, sesa në mediat lokale. Kur bëhet fjalë për komunitete të vegjël, në Shqipëri dihet fakti se si krijohen lidhjet midis qytetarëve dhe aktorëve të ndryshëm shoqërorë. Nga kontaktet që kemi zhvilluar me gazetarë dhe drejtues të mediave lokale, shpesh herë pohohet se pasqyrimi i problematikave lokale është më i lehtë të bëhet në mediat kombëtare, se sa në ato lokale. Në shumë raste eidentohen edhe kërcënime ndaj gazetarëve apo drejtuesve të këtyre mediave, të cilët marrin përsipër të pasqyrojnë një problematikë të qytetit.

Çipuri vë në dukje se mediat lokale janë nën kontrollin e pushtetit lokal në qytetet ku ato operojnë, çka sipas tij e vështirëson shumë punën e tyre për të raportuar në mënyrë të pavarur. *“Në shumë raste, ata vetë nuk kanë mundësi të luajnë rolin e tyre si media dhe të monitorojnë qeverisjen vendore, por edhe afëra të ndryshme që mund të ndodhin në aktorë të ndryshëm social. Nga ana tjetër, ata bëhen palë me qeverisjen vendore dhe borizan i aktiviteteve të bashkive në qytetet ku operojnë”,* thotë ai.

Këtë fakt e pohon dhe Edmond Isaku, kreu i Shoqatës së Mediave Lokale, që sipas tij 20% e mediave kanë bërë kompromis me pushtetin lokal. *“Personalisht nuk e kam vrarë mendjen për atë punë. Por në përgjithësi, 80% e mediave lokale nuk kanë rënë në grackën e kësaj strategjie, 20 % dihet që kanë përfutur ndonjë gjë, e kanë gabim dhe ato sepse do digjen. Kështu është”,* tha ai për Portën Vendore.

Sipas Aleksandër Çipës, TV-të lokale që kanë shërbyer si gjobëvënës apo u kanë shërbyer interesave të pronarëve duhet të mbyllen dhe në treg të qëndrojnë vetëm ato që i shërbejnë qytetarëve. *“Është e natyrshme që do mbyllen ato media, të cilat funksionojnë mbi bazën e informalitetit dhe kanë ekzistuar si mjete gjobëvënie në shoqërinë e këtij vendi. Por ne po flasim për disa media të cilat kanë krijuar shkollën e tyre, kanë krijuar përvojat profesionale dhe i karakterizon nga kredoja e të qenit misionar i informimit dhe jo misionar i shërbesave*

individuale të pronarit. Ne jemi për këtë gjë. Do thuash ti, po si ndahet kjo nga besueshmëria te publiku dhe nga besueshmëria tek audienca? Çdo njeri i përshtatet mundësisë dhe të themi situatës së tregut sepse edhe kjo është një situatë kalimtare, nuk do të jetë e përhershme”.

Për gazetarin dhe ekspertin e medias, Lutfi Dervishi, te gazetarët vihet re autocensurë, pasi nuk guxojnë të investigojnë aty ku ka interesat pronari. Ai vë në dukje se garantimi i lirisë së medias arrihet duke garantuar mjedisin e përshtatshëm për të ushtruar këtë liri. *“Liria e medias do të thotë që gazetari e përdor lirinë me përgjegjësi, pa e barazuar me lirinë e shprehjes. Që të jetë i lirë gazetari nuk duhet të censurohet, vetëcensurohet dhe të marrë vendimet vetëm bazuar mbi ndërgjegjen profesionale. Që media/gazetari të jetë i lirë duhet që të ketë një ambient që e garanton dhe mbështet lirinë e medias. Më shumë gazetarët kanë vetëcensurë, pra nuk u shkon në mendje të shkruajnë/investigojnë, jo vetëm aty ku pronari ka bizneset e veta, por dhe aty ku mendojnë se janë interesat e pronarit. Mungesa e gazetarisë kritike/investigative flet për praninë e censurës/vetëcensurës”.*